




mai ora premunt / gjëra të mëdha na presin



Nr. 932 Prot. Datë 13/12/2024

Nr. 9859 Prot. Datë 13/12/2024

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ky memorandum lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

- "Universiteti European i Tiranës", me seli në: Rruga "Xhanfize Keko", Nd.56, Tiranë, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) K62029010L, me emër tregtar "Universiteti European i Tiranës", përfaqësuar nga Z. Tildi Çadri, në cilësinë e Administratorit/Rektorit madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si "UET".

#### DHE

- "Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale" me seli në: "Bulevardi Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Ish-Shtëpia e Ushtarakeve, Tiranë, Shqipëri, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) K51726018J, me objekt veprimtarie si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, detyrim që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ligji organik nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar, neni 189, si dhe nga dokumente strategjikë si: Marrëveshja e Asociimi-Stabilizimit në nenin 73 të saj, "Pronësia Intelektuale". DPPI funksionon në formën e një agjencie autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, pranë ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), përfaqësuar nga Znj. Maria Solis Kapedani, në cilësinë e Drejtorisë së Përgjithshëm të Komanduar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si "DPPI".

#### Neni 1

#### Objekti i Bashkëpunimit

Objekti i këtij memorandumi është përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit midis UET dhe DPPI. Entitetet e mësipërme bien dakord të bashkëpunojnë për një afat të pacaktuar kohor më njëra-tjetër në fushat ku të dyja palët ushtrojnë aktivitetin e tyre kryesor dhe/ose plotësues. Pikat kryesore të bashkëpunimit do të jenë:

#### I. Kualifikim / Specializime

UET, do të ofrojë mundësinë për kualifikime të burimeve njerëzore në programe të të tre cikleve të studimit: Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave, Master Ekzekutiv dhe Doktoratë. Gjithashtu, do të ofrojë mundësinë e trajnimeve të certifikuara 3-12 javore në fushat e interesit.

DPPI, vendos në dispozicion të UET burimet e saj të kualifikuara njerëzore për qëllime të mbulimit të aspekteve praktike të kurrikulës mësimore në secilin program mësimor.

#### II. Konsulencë

UET, do të ofrojë shërbime këshillimi dhe konsulencë të specializuar në të gjitha fushat e ekspertizës së vet akademike dhe profesionale, sipas interesave dhe termave preferenciale të dakortësuara midis palëve.

DPPI, do të ftohet në proceset e hartimit të programeve të reja të studimit, ose rishikimit të atyre ekzistuese për të reflektuar kërkesat e tregut të punës.

### **III. Praktika profesionale dhe mbështetja për punësim**

DPPI, në përputhje me nevojat dhe mundësitet e disponueshme do të pranojë studentë në praktika profesionale duke iu dhënë mundësinë studentëve të UET të shfaqin/përmirësojnë aftësitet e tyre profesionale, si dhe të ofrojë mundësi punësimi, sipas rastit.

### **IV. Projekte studimore dhe kërkime me natyrë aplikative për industrinë**

- DPPI, do të mundësojë akses në informacion për hartimin e temave të diplomës, disertacioneve të studentëve UET dhe kërkimin shkencor të stafit akademik, duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënavë individuale.
- UET ofron realizimin e kërkimeve bazë dhe të aplikuara nga studentët e tre ciklevë të studimit dhe nga stafi i tij akademik, për çështje specifike me interes të përbashkët.
- Palët angazhohen të organizojnë dhe zhvillojnë veprimtari/ projekte/ evenete të përbashkëta në fushat e përbashkëta të interesit me fokus pronësinë industriale.
- Në raste të caktuara dhe kur krijohen detyrime me natyre financiare për palët, termat e bashkëpunimit në këtë fushë përcaktohen sipas rastit me marrëveshje të posaçme.

### **V. Partneritete në projekte ndërkombëtare**

- Palët angazhohen të bashkëpunojnë në projekte ndërkombëtare.

#### **Neni 2**

##### **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

Institucionet marrin përsipër që në perputhje me interesat institucionale, mundësitet e tyre duke kapacitetet përkatëse, të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës të gjitha burimet njerëzore dhe materiale, për arritjen e qëllimeve që parashikon kjo marrëveshje.

Institucionet do të ruajnë konfidencialitetin e njëra-tjetrës, për të cilat do të vendosen në dijeni si rrjedhojë e bashkëpunimit të ndërsjellë të palëve. Palët do të nxisin njëra-tjetrën për një bashkëpunim sa më të gjërë dhe intensiv duke eksploruar fusha të tjera bashkëpunimi

#### **Neni 3**

##### **Interpretimet**

Palët do të interpretojnë çdo pikë të kësaj marrëveshje, duke marrë parasysh vullnetin dhe dëshirën e mirë të se cilës prej palëve, deri në nënshkrimin e kësaj marrëveshje.

Kjo marrëveshje nuk mund të jetë pjesë e ndonjë konflikti gjyqësor.

#### **Neni 4**

##### **Komunikimi**

Palët do të caktojnë personat e kontaktit që do të janë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënavëve të jetë i shpejtë, konkret dhe efektiv. Në rastet e shmangjes nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Personat e kontaktit per se cilën palë, në kuadër të implementimit të këtij memorandumi janë:

##### **Për DPPI:**

Znj. Sonila Meka; e-mail: sonila.meka@dppi.gov.al; Mob.+355 673571802

##### **Për UET:**

Z. Kristi Bello; e-mail: kristi.bello@uet.edu.al; Mob.+355 69 202 0303

#### **Neni 5**

##### **Ndryshime**

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të dy palëve të përfshirë në të.

Sipas rastit, për bashkëpunime specifike palët do të nënshkruajnë një akt të dytë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Neni 6**  
**Përfundimi i Memorandumit**

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim, të arsyetur nga Pala tjeter.

Palët marrin përsipër t'u përbahen termave dhe kushteve të memorandumit duke ofruar dhe shkëmbyer informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, deri para datës së përfundimit të tij.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, një për se cilën Palë.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 13/12/2024 dhe hyn në fuqi menjëherë.

"Universiteti European i Tiranës"

Administratori  
Z. Tildi Çadri



"Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale"

Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar  
Znj. Maria Solis Kapedani

